



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE

Nr. 1170 Prot.

Tiranë, më 9 . 7 .2026

Lënda: Njoftim me shkrim për dokumenta shtesë.

MANASTIRI FARM Sh.p.k
Adresa: Vermik, Njesia administrative Brataj, Bashkia Selenicë, Vlorë.
Tel: 0692558544

I nderuar, Z. Alimuçaj,

Ju informojmë se aplikimi juaj, me Nr. 3933 Prot., dorëzuar më datë 30.09.2025, për masën 16, “Mbështetje për investime në agroturizëm me një masë përfitimi në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë 15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milion) për subjekt”, në lidhje me investimin, “Ndërtimi i 10 (dhjetë) kabinave dhe restorantit”, është marrë në dorëzim dhe shqyrtuar nga Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve.

Bazuar në Udhëzimin Nr. 14, datë 28.03.2025, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, i ndryshuar, ju informojmë se duhet të dorëzoni dokumentet si më poshtë:

1. Të ridorëzohet Formulari i Aplikimit sipas Aneksit 10, ku të vendoset “Data”. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se te Formulari i Aplikimit nuk është vendosur data).*
2. Të dorëzohet dëshmia e penalitetit për ortakun, Z. Arbri Alimuçaj, jo më vonë se 30 ditë nga data e aplikimit. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se keni dorëzuar dëshmin e penalitetit vetëm për administratorin, Zaim Alimuçaj).*
3. Të dorëzohet vërtetim nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë) që nuk keni detyrime të pa paguara. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se keni detyrime tatimore të papaguara).*
4. Të dorëzohet vërtetim nga Bashkia Selenicë ku të konfirmohet që kontrata e qirasë me nr. 2027 Prot., datë 23.08.2022, e lidhur midis palëve është aktive.
5. Të dorëzohen certifikatat e pronësisë, hartat kadastrale dhe kartelat e pasurisë për pasuritë e aplikuara *(Kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit, si dhe në kartelën e pasurisë duhet të jetë shënuar kontrata e qirasë).*

6. Të ridorëzohet preventivi i gjeneruar sipas "Hartim preventivi nga manuali i çmimeve në ndërtim" nga e-Albania dhe nënshkruar me vule elektronike nga inxhinier i licensuar, vetëm për investimin e aplikuar. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se në preventivin e dorëzuar pasqyrohen zëra edhe për aktivitete të tjera për të cilat nuk është aplikuar, si dhe preventivi nuk është gjeneruar nga e-Albania).*
7. Të dorëzohet leja e ndërtimit/deklaratë paraprake për kryerje punimesh/njoftim punimesh, sipas legjislacionit në fuqi, ku të paraqitet investimi për të cilin keni aplikuar, si dhe të përcaktohet numri i pasurisë mbi të cilën do të kryhet investimi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës.
8. Të dorëzohet planvendosja e të gjithë projektit të ri me nënshkrim elektronik.
9. Të ridorëzohet Raporti Teknik me nënshkrim elektronik, bashkëlidhur licencën. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se Raporti Teknik është dorëzuar fotokopje).*
10. Të ridorëzohet projekti arkitektonik për investimin e aplikuar, nënshkruar me vule elektronike, bashkëlidhur licencën. *(Në projektin e dorëzuar me dosjen e aplikimit pasqyrohet ambient për mbarështim gjedhi).*
11. Të ridorëzohet relacioni arkitektonik për investimin e aplikuar, nënshkruar me vule elektronike, bashkëlidhur licenca përkatëse. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se në relacionin arkitektonik të dorëzuar me dosjen e aplikimit pasqyrohen edhe aktivitete të tjera).*
12. Të ridorëzohet relacioni konstruktiv për investimin e aplikuar, nënshkruar me vule elektronike. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se relacioni konstruktiv është dorëzuar fotokopje).*
13. Të dorëzohen relacionet dhe projektet: Elektrike, MNZ, Hidro-Sanitare dhe HVAC, të cilat duhet të jenë të nënshkruara me vule elektronike nga inxhinier/specialist i licensuar, bashkëngjitur licencat përkatëse. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se relacionet dhe projektet, Elektrike, MNZ, Hidro-Sanitare dhe HVAC nuk janë dorëzuar).*
14. Të ridorëzohet ofertë origjinale për investimin e aplikuar (ndërtimin e 10 kabinave dhe restorantit), shoqëruar me datë, firmë, vule dhe vlefshmërinë e ofertës, e firmosur dhe vulosur, e shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues. Oferta për punimet civile duhet sipas "Hartim preventivi nga Manuali i çmimeve në ndërtim". Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë. Ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njëri tjerin dhe me aplikantin. Në lidhje me zërat e ofertës, "Analizë jashtë liste"(AN) dhe "Paisje jashtë liste"(PJ), të dorëzohen nga ofertuesi, të dhëna të detajuara sipas specifikimeve përkatëse teknike dhe materialeve të përdorur. *(Nga kontrolli administrativ rezulton se oferta e dorëzuar nuk është sipas preventivit, nuk ka të përcaktuar vlefshmërinë, nuk ka datë lëshimi).*
15. Në lidhje me deklaratimet tuaja në planin e biznesit pjesa përshkruese dhe financiare të jepet informacion sqarues si më poshtë:

Pika 1.2, “Struktura e pronësisë”. Të jepet pronësia e aktivitetit ku zhvillohet agroturizmi, si dhe numri i pasurisë ku do të zhvillohet investimi i ri.

- Në lidhje me Plani i Biznesit Pjesa Financiare të dorëzohen/plotësohen:

- “Tabela e ofertave”, të plotësohen të gjitha kollonat e paplotësuara.
 - “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve”, të plotësohen të gjitha kollonat e paplotësuara.
- Të ridorëzohet Plani i Biznesit, pjesa Përshkruese dhe Financiare të printuara dhe në formatin CD (në format të punueshëm Word, Excel), ku të jenë të pasqyruara të gjitha ndryshimet e kërkuara më sipër. Të dhënat e pjesës financiare duhet të jenë të njëjta me të dhënat e pjesës përshkruese, preventivin dhe me ofertën.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularit të regjistrimit në QKB të ofertuesve, Certifikatës/Vërtetimit të pronësisë, AMTP-së, hartës treguese) të jetë i noterizuar.

Ju lutemi të dorëzoni dokumentat e kërkuara më lart pranë zyrave të AZHBR Tiranë, mundësisht brenda një afati kohor prej 10 ditësh pune nga data e marrjes së këtij njoftimi por jo më vonë se data 27.02.2026. Çdo dokumentacion shtesë i dorëzuar, por i pakërkuar nga AZHBR, nuk do të merret në konsideratë në vlerësimin e aplikimit.

Dorëzimi i dokumenteve përtej datës 27.02.2026 është kriter skualifikimi, (me përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit).

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ardita Kuçi

